

V E N D I M
Nr.555, datë 2.12.1999

**PËR SHPRONËSIMIN PËR INTERES PUBLIK TË PASURIVE TË PALUAJTSHME, QË
PREKEN NGA NDËRTIMI I SUPERSTRADËS VORË-MAMINAS, PJESË E
SUPERSTRADËS TIRANË-DURRËS**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 4 dhe 9 të ligjit nr.7848, datë 25.4.1994 “Për shpronësimin për interes publik, si dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurive të paluajtshme”, me propozimin e Ministrisë së Transportit, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I:

1. Shpronësimin për interes publik të pasurive të paluajtshme, që preken nga ndërtimi i superstradës Vorë-Maminas, pjesë e superstradës Tiranë-Durrës, të ndodhura në territorin e rrethit të Tiranës dhe në Bashkinë e Vorës, sipas listave emërore, të cilat i bashkëlidhen këtij vendimi.

2. Shpronësimi të bëhet në favor të Ministrisë së Transportit.

3. Pronarët e pasurive të paluajtshme që shpronësohen të kompensohen në lekë, në vlerë të plotë, sipas listave emërore të pronarëve dhe sipas masës së kompensimit përkatës, që paraqiten në tabelën, që i bashkëlidhet këtij vendimi, për shumën e përgjithshme prej 235 632 572 (dyqindetridhjetëepesë milionë e gjashtëqindetridhjetëedy mijë e pesëqindeshtatëdhjetëedy) lekësh.

4. Ky fond të përballohet nga fondi i miratuar për këtë objekt në buxhetin e vitit 1999, për Ministrinë e Transportit, në zërin “shpronësime”.

5. Shpronësimi të përfundojë brenda vitit 1999.

6. Ngarkohen Ministria e Transportit, Ministria e Pushtetit Lokal, Këshilli i Rrethit të Tiranës dhe Bashkia e Vlorës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTRI
Ilir Meta